



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

Nr 1866 Prot

Elbasan më 31 /03/2020

**VENDIM**

Nr 33 datë 31 /03/2020.

**Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë, për muajin SHKURT 2020**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2020 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin SHKURT 82 familje me fond 270.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**  
**Klajd Gripshi**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**  
**Hektor Çiftja**





522

01.04.2020



3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 156F Prot.Datë 31 .03. 2020

## VENDIM

NR. 34 DATË 31 .03. 2020

## MBI

"Transferim mallrash nga Qendra Ekonomike e Arsimit në Qendrën Sociale "Balashe".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_ . 03. 2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Për transferim mallrash nga Qendra Ekonomike e Arsimit në Qendrën Sociale "Balashe", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë të Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe VKM nr.243, datë 24.03.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqsisë natyrore"

## VENDOSI :

1. Transferimin pranë Qendrës Sociale "Balashe", për tu përdorur nga kjo e fundit për vaktet e përgatitura me të cilat furnizohen çdo ditë personat në nevoj që trajtohen në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr.243, datë 24.03.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqsisë natyrore".  
Vlera e përgjithshme e artikujve që do të tranferohen është 711,499 lekë.
2. Qendra Ekonomike e Arsimit, në transferimet e ardhshme të buxhetit, do të kompesohet për fondin e përdorur nga kuotat ushqimore për likujdimin e faturave të mallrave ushqimorë të transferuar sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë, Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Qendra Sociale "Balashe".
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Prefekti.

SEKRETAR  
Klajdi Gripshi

KRYETARI  
Hektor Ciftja





3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1568 Prot.  
2020

Datë 31 .03.

VENDIM

NR. 35 DATË 31 . 03. 2020

MBI

“SHITESË E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA DHE E SHPENZIMEVE, NË  
BUXHETIN E VITIT 2020”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, udhëzimin nr.2, datë 20.01.2020 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020” dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.201, datë 24.12.2019 mbi “Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2020”, pasi mori në shqyrtim materialet mbi “Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve, në buxhetin e vitit 2020”, të përgatitura nga administrata e Bashkisë Elbasan,

VENDOSI :

1. Të miratojë rritjen e të ardhurave të trashëguara dhe të shpenzimeve, pjesë e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2020, si më poshtë :

A. Te ardhurat :

1. Trashëguar transfertë e pakushtëzuar (grant) 10,000,000 lekë
  2. Trashëguar të ardhura nga taksat dhe tarifat 21,000,000 lekë
- Gjithsej : 31,000,000 lekë

B. Shpenzimet (shtesë e buxhetit për vitin 2020) :

Emërtimi/ programi	Kodi instituc.	Prog.	Kap.	Art.	Shuma/lekë
Planif.Menaxh.& Admin.	2109001	01110	1	600	10,000,000
Planif.Menaxh.& Admin.	2109001	01110	5	600	16,500,000
Planif.Menaxh.& Admin.	2109001	01110	5	601	4,500,000
<b>Gjithsej :</b>					<b>31,000,000</b>

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

**SEKRETAR**  
**Klajdi Gripshi**

**KRYETARI**  
**Hektor Ciftja**





3

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 156P Prot.

Datë 31.03.2020

VENDIM

NR. 36 DATË 31.03.2020

MBI

“Miratim në parim i fondeve për investime në arsim, në bashkëfinancim me FZHR”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_.03.2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Miratim në parim i fondeve për investime në arsim, në bashkëfinancim me FZHR”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, si dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.201, datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2020”,

VENDOSI

1. Miratimin në parim për financimin në masën 40%, të objekteve : “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Kostandin Kristoforidhi” dhe “Rikonstruksion i shkollës së mesme artistike “ONUFRI”, për periudhën 2020-2021, kontribut Bashkisë Elbasan, në bashkëfinancim me FZHR (60%), “Grante për Arsimin”.
2. Në rast të miratimit të granteve për këto dy projekte, Bashkia merr përsipër financimin e shumës 74,978,113 lekë, kontribut i Bashkisë Elbasan për vitin 2020, sipas pikës 1 të këtij vendimi, duke bërë rialokimin e fondeve në buxhet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Sektori Projekteve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETARI  
Klajdi GRIPSHI

KRYETARI  
Hektor Çiftja

